

Njoftim për konsultim publik

Titulli i Projekt-aktit : Per miratimin e paketes fiskale per vitin 2023.

Datat e konsultimeve publike:

| Njesia Administrative | Data | Ora | Vendi |
|------------------------------|-------------------|--------------|--------------------------------------|
| Qerret | 08.11.2022 | 11:00 | Njesia Administrative Qerret |
| Qelez | 08.11.2022 | 15:00 | Njesia Administrative Qelez |
| Gjegjan | 09.11.2022 | 11:00 | Njesia Administrative Gjegjan |
| Rrape | 09.11.2022 | 15:00 | Njesia Administrative Rrape |
| Puke | 11.11.2022 | 11:00 | Parku i Liqenit |

Propozuesi : Projekt –akti është propozuar nga ana e Kryetarit të Bashkisë.

Sqarime për projekt-aktin :

Në zbatim të pikës 3, të nenit 34, pikës 1,2,4,5, të nenit 35, germës “ f ”, të nenit 54, pikës 3, të nenit 55, të ligjit nr.139/2015 “ Për vetëqeverisjen vendore ”, ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “ Për financat e vetëqeverisjes vendore”, ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore ”, të ndryshuar, ligjit nr. 142/2015 datë 17.12.2015, për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar, ligjit nr.106/2017 për disa disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.9632,datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore ”, të ndryshuar, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “ Për tatimin mbi të ardhurat ” ,të ndryshuar”, ligjit nr. 9723, datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit ”,të ndryshuar, ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “ Për procedurat tatimore në R.SH ”, të ndryshuar, ligjit nr. 10081, datë 23.02.2009 “ Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë ”, të ndryshuar, ligjit nr. 10304, datë 15.07.2010 “ Për sektorin minerar në R.SH ”, ligjit nr. 9975, datë 28.07.2008 “ Për taksat kombëtare ”, të ndryshuar , ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje ” të ndryshuar, ligjin nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, ligjit nr. 24/2017, datë 09.03.2017 “Për administrimin e ujëtjes dhe kullimit ”, ligjit nr.93/2015 “Për turizmin”, ligjit nr.10465 “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, ligjit nr. 8450,datë 24.2.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, të ndryshuar, ligjit nr.9385, datë 4.5.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, ligjit nr.9693, datë 19.3.2007 “Për

fondin kullosor”, të ndryshuar, ligjit nr.10279, datë 20.05.20010 “Për kundravajtjet administrative”, VKM nr.132, datë 7.3.2018 “Për metodologjinë për përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme “ndërtesa”, e bazës së taksës për kategori specifike, natyrën dhe prioritetin e informacionit dhe të dhënave për përcaktimin e bazës së taksës, si dhe të kriterëve dhe rregullave për vlerësimin alternativ të detyrimit të taksës”, VKM nr. 783, datë 10.11.2011 “Për procedurat e ndarjes së të ardhurave të taksës vjetore të mjeteve të përdorura me njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, VKM nr.1064, datë 22.12.2010 për disa ndryshime në VKM nr.391 datë 21.06.2006 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe kullotave”, VKM nr. 54, datë 05.02.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, të ndryshuar, VKM nr.344, datë 19.4.2017 për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.970, datë 2.12.2015, të KM, “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj”, VKM nr.319, datë 31.5.2018 “Për miratimin e masave për kostot e menaxhimit të integruar të mbetjeve”, VKM nr.285, datë 27.06.2002 “Për tarifën e shërbimeve që kryen policia e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimit ndaj shtetasve dhe personave juridikë e fizikë, vendas e të huaj”, VKM nr.7, datë 4.01.2012 “Për përcaktimin e procedurave dhe të dokumentacionit të nevojshëm për arkëtimin e taksës së rentës minerare”, të ndryshuar, Udhëzimit nr.24, datë 02.09.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, Udhëzimit të MF nr.1, datë 12.01.2007 “Për përcaktimin e veprimtarive që trajtohen si veprimtari tregëtare apo shërbimi, ambulante si dhe procedurat e regjistrimit të tyre në organin tatimor”, Udhëzimit nr. 26, datë 04.09.2008 “Për taksat kombëtare” të ndryshuar, Udhëzimit nr.32, datë 31.12.2013, “Për tatimin e thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël”, të ndryshuar, në zbatim të nenit 7 të ligjit nr. 8378, datë 22.07.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjit nr. 8224, datë 15.05.1997 “Për organizimin dhe funksionimin e policisë bashkiake...”, i ndryshuar me ligjin nr. 8335/23.04.1998 të ndryshuar me qëllim:

1. Përfshirja qytetare, grupeve të interesit, komunitetit në përgjithësi, mbetet pikë kyçe e suksesit jo vetëm në hartimin e Paketës Fiskale, por sidomos zbatimin e saj.
2. Planifikim i kemi mbështetur në shpërndarjen sa më të drejtë të ngarkesës tatimore duke bërë përcaktimin e nivelit të tarifës sipas llojit të aktivitetit, sipas vendodhjes gjeografike, duke lehtësuar bizneset në zona më pak të zhvilluara (Njesitë Administrative) Gjegjan, Rrape, Qerret dhe Qelëz.

3. Mirëadministrimi i burimeve financiare nëpërmjet planifikimit sa më real të paketës fiskale si dhe zbatimi i rregulloreve,dhe urdhëresave përbën moton e punës tonë.

Pjesëmarrës :

- **Nga ana e Bashkisë :** Antaret e Komisionit të Ekonomisë dhe Financës të Këshillit, Koordinatori për Njoftimin dhe Konsultimin Publik, këshilltarë, drejtues/punonjës të administratës që lidhen me çështjen që konsultohet.
- **Nga komuniteti :** Banorët e njesive administrative.
- **Format e konsultimit :** Degjesa publike.

| | |
|--|---|
| <p>Qëllimi i këshillimit publik</p> | <p>Këshillimi publik synon tërheqjen e mendimit të qytetarëve në lidhje me këtë projekt-akt, i cili prek të gjithë komunitetin.</p> <p>Këshilli i Bashkisë, si përfaqësues i komunitetit, kërkon të marrë më shumë informacion për ndikimin dhe efektet që ky vendim mund të ketë në komunitetin e Bashkisë dhe më gjërë, nëse ky projekt-vendim i shërben përmirësimit të jetës së komunitetit, nëse ai i shërben interesit publik si dhe nëse ai duhet miratuar sic është paraqitur, nuk duhet miratuar, apo duhet të miratohet i përmirësuar.</p> |
| <p>Përshkrimi i çështjes që trajton projekt-akti</p> | <p>Per miratimin e paketes fiskale per vitin 2023.</p> |
| <p>Pyetjet që ngre Këshilli ndaj publikut</p> | <p>Këshilli i Bashkisë ka marrë projekt-vendimin e propozuar nga ana e Kryetarit të Bashkisë dhe bazuar në Ligjin 139/2015 Neni 18, ka vendosur kalimin e tij në konsultim publik.</p> <p>Këshilli i Bashkisë është i interesuar të marrë opinionin e komunitetit në lidhje me çështjet si vijon :</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Përfshirja qytetare,grupeve të interesit,komunitetit në përgjithësi,mbetet pikë kyçe e suksesit jo vetem në hartimin e Paketës Fiskale ,por sidomos zbatimin e saj . 2. Planifikim e kemi mbështetur në shpërndarjen sa më të drejtë të ngarkesës tatimore duke bërë përcaktimin e nivelit të tarifës sipas llojit të aktivitetit,sipas vendodhjes gjeografike,duke lehtësuar bizneset në zona më pak të zhvilluara (Njesitë |

| | |
|--|---|
| | <p>Administrative) Gjegjan, Rrape, Qerret dhe Qelëz .</p> <p>3. Mirëadministrimi i burimeve financiare nëpërmjet planifikimit sa më real të paketës fiskale si dhe zbatimi i rregulloreve, dhe urdhëresave përbën moton e punës tonë.</p> |
| <p>Detaje të çdo takimi publik apo dëgjese publike që do të organizohet në lidhje me projekt-aktin për këshillim;</p> | <p>Bashkia Puke dhe Këshilli i Bashkisë do të organizojnë konsultime publike me banorët e bashkisë, sepse të gjithë preken nga ky vendim.</p> <p>Konsultimi publik do të zhvillohet edhe online nëpërmjet në faqet zyrtare të të Bashkisë duke marrë mendime e sygjerime.</p> |
| <p>Kontaktet dhe afatet e dërgimit të komenteve, rekomandimeve, vërejtjeve;</p> | <p>Komentet dhe rekomandimet tuaja mund të jepen direkt nëpërmjet pjesmarrjes Suaj në takimet publik, por në pamundësi për të marrë pjesë në këto konsultime, ato mund të dërgohen me email</p> <p>BRENDA DATËS 26.11.2021</p> <p>Email: keshillibashkiakupuke@gmail.com</p> <p>www.bashkiakupuke.gov.al</p> |
| <p>Ndryshimet kryesore dhe/ose alternativat e mundshme</p> | <p>Opsionet e mundëshme janë për t'u shqyrtuar nga ana e Këshillit :</p> <p>Mund të rekomandohen alternativa të tjera.</p> |
| <p>Projekt-vendimi, relacioni shoqërues, studime apo materiale me informacion nëlidhje me çështjen që konsultohet</p> | <p>Projekt-vendimin mund t'a gjeni në linkun https://bashkiakupuke.gov.al</p> |
| <p>Shpjegim të procesit që do ndjekë dhe veprimet që do të ndërmarrë Këshilli për të shqyrtuar rekomandimet nga publiku deri në marrjen e vendimit</p> | <p>Konsultimi publik do të realizohet sipas Kalendarit të Konsultimeve Publike.</p> <p>Pas realizimit të konsultimeve publike me komunitetin dhe grupet e interesit, Këshilli i Bashkisë do të ndjekë hapat si vijon :</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Mbajtja e procesverbalit të çdo takimi publik dhe bërja publike e tyre. 2. Marrja e Rekomandimeve me postë dhe bërja e tyre publike. 3. Realizimin nga ana e Sekretariatit të Këshillit i një Përmbledhje të Rekomandimeve, që përfshin të gjitha mendimet dhe propozimet që do të vijnë nga komuniteti dhe bërja publike e kësaj Përmbledhje. 4. Dërgimi i kësaj Përmbledhje Rekomandimesh Kryetarit të Bashkisë, |

| | |
|-------------------|---|
| | <p>Komisionit të Ekonomisë dhe Financës.</p> <ol style="list-style-type: none">5. Shqyrtimi nga ana e komisioneve (mbledhjet e komisioneve janë të hapura për publikun sipas datave të parashikuara në kalendar) të cdo rekomandimi dhe diskutimi i tij në komisione për të dalë me një vendim se cilat propozime mund të merren në konsideratë dhe cilat nuk mund të merren dhe për çfarë arsye.6. Hartimi i projekt-vendimit të përmirësuar bazuar në rekomandimet e konsultimit publik.7. Diskutimi dhe miratimi i aktit në seancën e hapur të Mbledhjes së Këshillit.8. Informimi i personave që kanë dhënë rekomandime për aktin, për marrjen në konsideratë të rekomandimit ose për mosmarrjen në konsideratë dhe arsyet e mosmarrjes në konsideratë të tij.9. Publikimi i aktit në faqen e Këshillit të Bashkisë dhe në tabelat e informimit10. Njoftimi i administratës për aktin e miratuar11. Monitorimi i zbatimit të tij |
| Data e publikimit | 03.10.2022 |